



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 404, datë 30.6.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËVE "MIQËSIA" DHE "AZEM
HAJDARI - GJELBËRIMI", TË NDODHURA BRENDË KONTURIT
TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, ZONA 4, NJËSIA ADMINISTRATIVE
DURRËS, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 400 276 890 (një miliard e katërqind milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjellbërimi", të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, të cilat shërbejnë si rrugë lidhëse me aksin kryesor të rrugës "Azem Hajdari".
2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 280 055 378 (dyqind e tetëdhjetë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjellbërimi", të

ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, të cilat shërbejnë si rrugë lidhëse me aksin kryesor të rrugës “Azem Hajdari”.

3. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për rikonstruksionin e rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari - Gjellbërimi”, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT.3163/1
DATË 1. 7. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

